

VENDIM
Nr. 212, datë 17.8.2022

MBI HEQJEN E LICENCËS NR. 380, SERIA T17, PËR VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË “ALIN TRADING” SHPK, ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 137, DATË 6.9.2017

Në mbështetje të nenit 16, nenit 17, pika 4 dhe nenit 42, pika 1, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 5, germa “ç” dhe nenit 9, germa “c” të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe pikës 3.6.4 dhe pikës 5.1, germa “ç” të “Kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.8.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1458/2 prot., datë 10.8.2022, të përgatitur nga grupi i punës “Mbi heqjen e licencës nr. 380, seria T17, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë ‘Alin Trading’ sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 137, datë 6.9.2017”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 143, datë 6.6.2022, vendosi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 380, seria T17, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Alin Trading” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 137, datë 6.9.2017, për arsye se shoqëria nuk kishte shlyer në afat ndaj ERE-s pagesën rregullatore të vitit 2021 për licencën për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, e po ashtu nuk kishte depozituar në ERE asnjë dokument apo argument, në lidhje me moszbatimin e këtij detyrimi.

- Me shkresën nr. 517/1 prot., datë 10.6.2022, ERE i ka njoftuar shoqërisë vendimarrjen si më sipër, duke i bërë me dije se ka të drejtën për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së këtij njoftimi. Shkresa e dërguar shoqërisë është kthyer mbrapsht nga posta, ndaj i është dërguar dhe me postë elektronike, e skanuar. Në këto rrethana, përveç sa më sipër, shoqëria nuk ka zbatuar dhe përcaktimet e pikës 3.6.4 të kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, ku është parashikuar detyrimi i të licencuarve për të njoftuar ERE-n brenda 10 ditëve për çdo ndryshim të adresës.

- Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 143, datë 6.6.2022, është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 101, datë 7.7.2022.

- Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në njoftimin e vendimit të sipërcituar (afati i fundit data 6.8.2022), duke e përllogaritur këtë afat 30 ditë nga marrja dijeni nga Fletorja Zyrtare, rezultoi se subjekti nuk kishte marrë asnjë masë për shlyerjen e debisë apo për të dhënë shpjegime në lidhje me këtë fakt, si dhe nuk ka bërë përpjekje për të shmangur shkakun ligjor që çoi ERE-n në fillimin e procedurës për marrjen e masës administrative për heqjen e licencës.

- Në nenin 42, pika 1, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenin 5, germa “ç” të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, si dhe pikën 5.1, germa “ç” të “Kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”, parashikohet, se: “ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE.”.

- Në nenin 9, germa “c”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, parashikohet, se: “Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat, sipas nenet 7 dhe 8 të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë, për: c) të hequr licencën subjekt i kushteve të përcaktuara në pikat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe / ose “d” të nenit

5 të kësaj rregulloreje në bazë të propozimit të paraqitur në raport, në përputhje me nenin 8 të kësaj Rregulloreje.

- Me heqjen e licencës nr. 380, seria T17, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 137, datë 6.9.2017, shoqëria “Alin Trading” sh.p.k. nuk mban më statusin e të licencuarit nga ERE dhe nuk mund të ushtrojë më veprimtarinë për të cilën ishte licencuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të heqë licencën nr. 380, seria T17, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Alin Trading” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 137, datë 6.9.2017.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e sipërcituar bëhet e pavlefshme.

3. Grupi i punës të njoftojë shoqërinë “Alin Trading” sh.p.k. dhe Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a. vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti